



Buletini Mjedisor

MBJELLJE MASIVE PËR TË PËRMIRËSUAR SITUATËN E PYJEVE NË SHQIPËRI

RIPYLLËZIMI I ZONAVE TË DEGRADUARA, ELBASAN



01 Shkurt 2016 - Kryeministri Edi Rama, i shoqëruar nga Ministri i Mjedisit Lefter Koka ishin të pranishëm në fillimin e

zbatimit të projektit të rehabilitimit të një zone të degraduar në Elbasan. Në këtë takim morrte pjesë edhe Kryetari i Bashkisë së Elbasanit Qazim Sejdiu, deputetë të qarkut Elbasan, përfaqësues të pushtetit lokal, si dhe drejtues dhe ekspertë të projektit.

Projekti parashikon mbjelljen e 3000 fidanëve të rinj, të llojit akacie dhe plep, në një sipërfaqe prej 2 ha, në një nga zonat, ku erozioni ka shkaktuar dëme serioze në ekonominë dhe infrastrukturën e banorëve të zonës, duke i shtrirë efektet edhe përgjatë lumit Shkumbin.

Ky projekt i rëndësishëm i ndërmarrë nga Ministria e Mjedisit parashikon ndër të tjera, sistemimin e shtratit të lumit pranë urës Polis, Valë dhe përgjatë rrjedhës; thellimin e shtratit të lumit dhe pastrimin e materialeve inerte të grumbulluara aty.

Ministri i Mjedisit Lefter Koka, u shpreh se masat shumë-dimensionale të ndërmarrja deri tani, do të jenë afatgjata, deri në rehabilitimin e plotë të sipërfaqeve të dëmtuara. “Kjo pjesë është dëmtuar pas reshjeve, që po shoqërohen së fundi edhe me përmblytje, të cilat janë kthyer në një ngjarje të përvitshme, jo vetëm në veriun e Shqipërisë dhe Ultësirat e Lezhës, por tashmë edhe në Jug, si edhe këtu në Elbasan.

Masat që ne kemi parashikuar janë shumë dimensionale, që nga Moratoriumi, të cilin unë e konsideroj një vendim historik, dhe që ne po e shoqërojmë edhe me mbjellje masive. Ne kemi filluar rehabilitimin në disa zona shumë të degraduara, siç është dhe ky rast në fjalë, dhe planet tona janë për të punuar në vijimësi për gjatë gjithë vitit”.

Duke e vlerësuar Moratoriumin 10 vjeçar për pyjet si të vetmen përgjigje ndaj shfrytëzimit barbar të tyre, Kryeministri Rama u shpreh se masa të tjera të rëndësishme do të ndërmerren kundër krimeve ndaj mjedisit, në mënyrë që në fund të 10 viteve Shqipëria të ketë një pamje krejt tjetër, përsa i përket ekuilibrave të natyrës. “Kjo është kostoja e tmerrshme e shumë viteve shfrytëzimi barbar. Moratoriumi është e vetmja përgjigje për të pasur një ripërtëritje të të gjithë pyjeve dhe për të rivendosur ekuilibrat natyrorë, pa të cilët nuk ka pritë, nuk ka shtet që e mbron dot popullin nga përbytja e ujit.

Nërkohë dhe mbjellja e fidanëve për të siguruar gjithë mbrojtjen në pikat kritike dhe për t'u shtrirë në të gjitha fashat e shkretuara nga sëpata e gjithë këtyre viteve, do të vazhdojnë intensivisht. Shumë shpejt do të kalojmë dhe paketën për Kodin Penal

kundër krimit mjedisor. Me gjithë këto masa, në harkun e 5 viteve, situata do të vihet në kontroll të plotë dhe do të fillojë rigjenerimi, dhe në harkun e 10 viteve Shqipëria do të ketë një pamje krejt tjetër, për sa i përket ekuilibrave të natyrës.”

RIGJENERIMI I FONDIT PYJOR - LUGINA E FANIT

02 Shkurt 2016 - Ministri i Mjedisit Lefter Koka, së bashku me Zëvendës Kryeministrin e vendit, z. Niko Peleshi



inspektuan sot fillimin e pyllëzimit në luginën e Fanit (Reps), ku në njërin prej zonave më të degraduara nga erozioni ka filluar mbjellja e 1500 fidanëve të llojit akacie.

Pas inspektimit të terrenit në të dyja anët e Rrugës së Kombit, z. Peleshi dhe Ministri Koka në prani edhe të Kryetarit të Bashkisë Rrëshen, Ndreç Deda, dhe deputetëve të zonës mbollën simbolikisht fidanët e parë.

Në falën e tij për mediat, Kryetari i Bashkisë Rrëshen, z. Deda, tha se do të bashkëpunojë me pushtetin qendror për të rehabilituar sipërfaqet e degraduara pyjore. “Po të shikoni të gjithë Rrugën e Kombit do të vini re se erozioni ka bërë punën e vet. Si kryetar bashkie do të bashkëpunoj me pushtetin qendror për të mbjellë fidanë dhe për të rigjeneruar pyjet të sipërfaqeve të tjera të degraduara”, tha z. Deda.

Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka theksoi se rehabilitimi i sipërfaqeve të degraduara dhe ripyllëzimi do të vijojnë gjatë gjithë vitit në mbarë vendin si masa dhe investime paralele me Moratoriumin 10 vjeçar të ndalimit të shfrytëzimit të pyjeve. Ministri Koka theksoi se bëhet fjalë për një sensibilizim të politikës dhe të shoqërisë shqiptare që kjo masë drastike të jetë funksionale.” – tha Ministri Koka.

Në falën e tij, z. Niko Peleshi u shpreh se qeveria shqiptare ka vendosur të ndryshojë qasjen ndaj mjedisit duke investuar tek shkaqet.

“Ka pasur një administrim të keq të pyjeve, gjë që e ka detyruar Ministrinë e Mjedisit dhe Qeverinë Shqiptare të ndërmarrë masën drastike të moratoriumit. Moratoriumi do të shoqërohet me sanksione shumë të forta për ata që do të guxojnë ta shkelin atë. Ndërkohë kemi shtuar forcat duke decentralizuar kompetencën edhe tek pushteti vendor. Kështu që nga njëra anë nën menaxhimin e pushtetit vendor dhe nga ana tjetër nën inspektimin e kontrollin e Inspektoriatit të Pyjeve do të mund të vendosim një regjim të ri për pyjet. Natyrisht që do të lejohen bashkitë të shfrytëzojnë pyjet vetëm për nevojat e ngrohjes.” - tha z. Peleshi.

Zona ku ka nisur ripyllëzimi ndodhet në një pjesë të pellgut ujëmbledhës të lumit Fan,

dhe karakterizohet nga pyje të degraduara në masën 70% nga prerjet ilegale dhe shfrytëzimet pa kriter. Dëmtimi i pyjeve ka sjellë erozion sipërfaqësor dhe të rëndë, ndërsa aluvionet që depozitohen në shtratin e lumit janë shkak për përmblytje.

RIPYLLËZIMI NË BERAT

07 Shkurt 2016 - Filloi programi i rigjenerimit të fondit pyjor me 5 mijë pisha të egra në një sipërfaqe prej dy hektarësh, në Malin Partizan përballë lagës muzeale të Goricës, Berat.

“Mbjelljet në zonat e dëmtuara krijojnë një bazë të mirë që brenda 5 vitesh të ketë një rehabilitim që do të ndihet kudo”, - deklaroi kryeministri Rama, i cili së bashku me Ministrin e Mjedisit Lefter Koka, dhe deputetë të zonës ndoqën nga pranë procesin e rigjellbërimit.

Rehabilitimi i kësaj zone, e dëmtuar rëndë për shkak të zjarreve natyrale e zjarrvënieve të qëllimshme, apo edhe prerjeve të qëllimshme, do të parandalojë një problem akut për qytetarët e Beratit, dëmtimin e banesave dhe objekteve historike nga erozioni dhe shkarjet e dheut.

“Është i domosdoshëm shoqërimi i moratoriumit me forcimin e masave ndëshkimore për krimet mjedisore. Paketa që do të kalojmë së shpejti në Parlament do të kompletojë kuadrin ligjor dhe do të krijojë një ekuilibër midis punës intensive për ripyllëzim dhe kontrollit shumë të rreptë për mënjanimin e cënimit të sipërfaqeve të gjelbra apo qoftë një peme të vetme, sepse nëse nuk funksionon e dyta, e para është si një mur i Kështjellës së Rozafës: ndërto ditën dhe prish natën” - tha kreu i qeverisë, Rama.

Ministri Koka deklaroi se “shumë prej qytetarëve shqiptarë kishin filluar ta besonin si një fat jetësën me degradimin dhe agoninë e pyjeve, ndaj jam i bindur që moratoriumi që kaloi në unanimitet është një ndër vendimet më historike të këtij Parlamenti dhe kësaj Qeverie. Ne do t'i kthejmë Shqipërisë atë sipërfaqe të gjelbrë që sot e kemi shumë të cunguar. Vetëm 26% e territorit të vendit është e mbuluar me bimësi, por unë jam i bindur që do të kemi pas 10 vitesh një Shqipëri shumë të ndryshme nga kjo që shohim sot”.

Sipërfaqja pyjore në rajonin e Beratit llogaritet rreth 16.000 ha, dhe si në shumë zona të tjera të Shqipërisë ka njohur një degradim të pandërprerë gjatë 25 viteve të fundit. Por me hyrjen në fuqi të Moratoriumit 10 vjeçar të Pyjeve dhe zbatimin e programit të sezonit vjetor të pyllëzimit, tashmë qytetit po i rikthehet kurora e tij e gjelbrë.



NË KETË NUMËR:
MBJELLJE MASIVE PËR TË PËRMIRËSUAR SITUATËN E PYJEVE NË SHQIPËRI - FQ 1
VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDSIMIT NË MEDIËS SHKURT 2015 - FQ2
FORCIMI I KONTROLLIT PAS MORATORIUMIT TË PYJEVE - FQ 3
AKTIVITETE TË TJERA NGA MINISTRIA E MJEDISIT - FQ4

“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Përmesuria e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkënduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime të mirëqenja afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik”.

ANALIZA VJETORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA



Zonave të Mbrojtura (AKZM).

I pranishëm në analizën e vitit të parë të punës për këtë agjenci ishte Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka. Prezantimi i punës u bë nga kreu i AKZM-së, z. Zamir Dedej, por edhe nga drejtues të drejtorive rajonale të Agjencisë në mbarë vendin.

Në nisje të takimit, z. Dedej prezantoi punën e bërë gjatë një viti, duke vënë theksin në ristrukturimin dhe organizimin e administratës së zonave të mbrojtura, forcimin e kapaciteteve të tyre menaxhuese, administrimin dhe monitorimin e tyre.

Ndërsa Ministri Koka në fjalën e tij, u shpreh se puna në terren që kanë bërë strukturat e AKZM-së në rang vendi është një kontribut domethënës për mjedisin shqiptar, por mbetet ende shumë punë për t'u bërë sidomos për të rikthyer besimin tek qytetarët shqiptarë.

“Nëse çdonjëri nga ne do të mund të bëjë mirë detyrën e caktuar, unë besoj se do të mundemi t'i rikthejmë Shqipërisë një territor më të shëndetshëm, më të bukur, më turistik, por ajo që është më e rëndësishmja është se të gjithë së bashku duhet të punojmë për të rikthyer besimin tek qytetarët shqiptarë” - tha Ministri Koka.

Duke folur për dëmet që janë shkaktuar në zonat e mbrojtura ndër vite, Ministri Koka u shpreh se po përgatitet ligji i ri për Zonat e Mbrojtura.

“Ajo që shumë shpejt do të kalojë në parlament do të jetë ligji i ri i Zonave të Mbrojtura, i cili parashikon krijimin e hapësirës së nevojshme ligjore që Agjencia të mund të vetëfinancohet. Unë jam i bindur që Shqipëria i ka resurset e nevojshme turistike për të mundur një zhvillim dhe forcim të mëtejshëm të kësaj Agjencie dhe zhvillim të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura. Sigurisht që kjo është një sfidë edhe më e madhe për ju, që krahas vetë-administrimit, t'i ktheni zonat e mbrojtura në shembuj të mirëfilltë të mirë-administrimit në vend.” – u shpreh Ministri i Mjedisit.

Ministri Koka u ndal edhe në të dhënat mbi frekuentimin e zonave të mbrojtura, sipas të cilave 220 mijë turistë

vendas dhe të huaj, janë regjistruar gjatë vitit 2015-të, si një konkretizim i politikës së Ministrisë së Mjedisit për të patur zona të mbrojtura të aksesueshme nga publiku i interesuar. Nga kjo shifër 2/3 janë turistë vendas dhe 1/3 turistë të huaj.

“Natyra dhe klima e Shqipërisë bën të mundur turizëm në të gjitha stinët, në 365 ditë të vitit, nëse pasuritë natyrore do të mirëmenaxhohen, duke kthyer kështu vëmendjen e turistëve të huaj dhe atyre vendas. Kemi rastin e Alpeve, që vitet e fundit ka pasur vëmendjen e shumë turistëve, si një destinacion për shumë qytetarë evropianë nga vende të zhvilluara, të cilët vlerësojnë natyrën e virgjër shqiptare”.

Duke iu referuar objektivave të këtij viti, z. Dedej u shpreh se “ndër synimet që Agjencia ka për këtë vit është mundësimi i aksesit në 43 zona të mbrojtura ekzistuese, nga të cilat aktualisht vetëm 13 prej tyre janë të arritshme nga turistët vendas dhe të huaj”.

Ndërkohë, do të vijnë investimet në rehabilitimin e zonave të mbrojtura, ndërtimi i qendrave të reja për informimin e publikut apo saktësimi i sipërfaqeve dhe kufijve të zonave të mbrojtura.

VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS SHKURT 2015

NR	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI
1.	ALBANIAN NICKEL	SHFRYTËZIM NËNTOKËSOR MINIERE	BILISHT, DEVOLL, KORÇË	PLOTËSIM DOKUMENTACIONI
2.	BASHKIA SKRAPAR	VP KRIJIMI I QENDRËS SPORTIVE	KANIONET E OSUMIT, SKRAPAR	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE
3.	AUTORITETI PORTUAL DURRËS	VP REHABILITIM I KALATAVE 7-8 PORTIT	PORTI DURRËS	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE
4.	LIMJON PESKA	VP RRIJTJE INTENSIVE E PESHKUT	SARANDË, VLORË	PLOTËSIM DOKUMENTACIONI
5.	BASHKIA DURRËS	VP NDËRTIM BANESE SOCIALE	SHKOZET, DURRËS	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE
6.	SOLOMON KONSTRUKSION	VP NDËRTIM MAGAZINE PËR PRODUKTE BUJQËSORE	FIER	PLOTËSIM DOKUMENTACIONI
7.	PRESTIGE ACQUA OLIGOMINERALE	VP FABRIKË IMBOTILIMI UJI TË PIJSHËM	HIMARË, VLORË	PLOTËSIM DOKUMENTACIONI
8.	KONSTRUKSION ALBANIA	VP PUNISHTË BRUMRASH	KRUJË, DURRËS	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE
9.	BLEDI	VTH SHFRYTËZIM KROMI	KALIMASH, KUKËS	DEKLARATË MJEDISORE
10.	SINA KONSTRUKSION	VP OBJEKT BANIMI GJASHTË KATËSH	TIRANË	VENDIM PËR VNM
11.	M. RRYCI	VP MBIKALIM RRUGE	DURRËS	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE
12.	KPMK	VP KAPANON INDUSTRIAL 2K	TIRANË	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE
13.	FLORJON	VP GODINË 6 K + 1K NËNTOKË	BERAT	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE
14.	AD SINANI	HOTEL & SHËRBIME TURISTIKE	VLORË	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE
15.	MINISTRIA E TRANSPORTIT	REHABILITIMI I PORTIT TË VLORËS LOTI 1	VLORË	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE
16.	SHKËMBI SHPK	SHTESË SIPERFAQEJE, MINIERË NËNTOKËSORE	KRASTË, DIBËR	VENDIM PËR VNM PARAPRAKE

LEJET MJEDISORE SHKURT 2015

NR.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	TIPI I LEJES	VENDIMI
1.	IBN Rishikim	Përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit përfshirë ambalazhimin dhe përzierien e çimentos, grumbullimin e betonit dhe prodhimin i bloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos	Propishtë, Pogradec, Korçë	Tipi B	Refuzim
2.	ItalShqipja S.R.L.	Prodhim i produkteve të përbëra tërësisht nga druri që përfshin: sharrimin shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, etj.	Zona Industriale Shkodër	Tipi B	Refuzim
3	Arjan Kotori	Lyerje dhe lustrim i makinave	Njësia Nr.4, Tiranë	Tipi B	Miratim
4.	Koxheri	Minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to, nxjerja e mineraleve të rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret	Martanesh, Dibër	Tipi B	Miratim
5	Granitis	Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale, jo metalike	Bradashesh, Elbasan	Tipi B	Miratim
6.	Sabahudin Allaj	Prodhim i alkoolit dhe pijeve alkoolike, duke përfshirë dhe fabrikat e birrës	Elbasan	Tipi B	Miratim
7.	Ayen As Energy	Rishikim, përziera dhe përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin, grumbullimin i betonit dhe prodhimin i bloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos	Rubik, Mirditë, Lezhë	Tipi B	Miratim

FORCONET KONTROLI PAS MORATORIUMIT TË PYJEVE



Gjatë inspektiveve të vazhdueshme në mbarë vendin, Inspektoriat Shtetëror i Mjedisit dhe i Pyjeve në kuadër të zbatimit të moratoriumit 10 vjeçar për shfrytëzimin e pyjeve, në këtë periudhë 15 ditore ka konstatuar gjatë inspektiveve dy raste shkeljesh në flagrancë.

ISHMP ka sekuestruar kamionin tip Ford, me targë AA 119KU me lëndë drusore. Ndaj drejtuesit të mjetit, shtetësit H.M., 50 vjeç, vendlindja Berat, u vendos gjobë në masën 5 milionë lekë të reja, ndërsa lëndë drusore dhe mjeti u sekuestruan. Ndërsa rasti i tjetër, sërisht ishte në flagrancë, pak ditë pas hyrjes në fuqi të Moratoriumit, më 11 shkurt 2016. ISHMP bëri ndalimin e drejtuesit të një kamioni me lëndë drusore në Shkodër.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP) siguron se kontrollet do të jenë të vazhdueshme dhe rigorozë në zbatim të Moratoriumit 10 vjeçar të pyjeve.

Kreu i Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, z. Ergys Agasi, apelon qytetarët që të respektojnë ligjin dhe të denoncojnë çdo rast abuziv që konstatohet në mjedis.

TAKIMI I PARË I PROJEKTI "KRIJIMI I SISTEMIT TË INFORMACIONIT PËR MENAXHIMIN DHE MONITORIMIN MJEDISOR NË LINJË ME RAPORTIMIN GLOBAL"



Është mbajtur në Ministrinë e Mjedisit takimi i parë i projektit "Krijimi i Sistemit të Informacionit për Menaxhimin dhe Monitorimin Mjedisor në linjë me Raportimin Global".

Projekti synon ngritjen e një sistemi të integruar të menaxhimit të informacionit mjedisor në linjë me detyrimet e raportimeve për tri Konventat e fushës së Mjedisit: Konventa e Biodiversitetit (CBD), Konventa e Shkretëtirëzimit (UNCCD) dhe Konventa e Ndryshimeve Klimatike (UNFCCC).

Në takimin e parë të Komitetit Drejtues që mbikqyr zbatimin e këtij projekti ishte e pranishme edhe znj. Yesim Oruc Kaya, Drejtore e Shtetit për UNDP –në, e cila përsëhendet fillimin e këtij projekti të rëndësishëm. Ndërsa Drejtori i Kabinetit në Ministrinë e Mjedisit, z. Argent Alltari, në pozicionin e Drejtorit të Projektit, shprehu besimin në realizimin me sukses të misionit të këtij projek-

ti, mjaft ambicioz në lidhje me krijimin e Sistemit të Informacionit për monitorimin mjedisor.

Më tej gjatë takimit, koordinatoresha e projektit për UNDP-në, znj. Odeta Çato, prezantoi objektivat dhe rezultatet e pritshme të projektit që lidhen me praktikën krahasuese globale, zgjedhjen e indikatorëve dhe parimet e përgjithshme për zhvillimin e Sistemit për Menaxhimin Kombëtar të Informacionit Mjedisor. Më pas, znj. Stephanie Hodge, konsulentja ndërkombëtare, e kësaj faze të projektit iu prezantoi të pranishmëve disa praktika globale krahasuese, si dhe treguesit dhe parimet e përgjithshme për zhvillimin e Sistemeve për Menaxhimin Kombëtar të Informacionit Mjedisor.


Komiteti Drejtues ka në përbërje të tij përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, përfaqësues nga INSTAT-i; përfaqësues nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, përfaqësues të shoqërisë civile, etj.

Projekti financohet nga Fondi Global i Mjedisit (GEF) me kontributin edhe të Qeverisë Shqiptare, për një periudhë 4 vjeçare.

Përfaqësuesit e Komitetit Drejtues mbështetën projektin e prezantuar, por patën edhe komente në lidhje me vazhdimësinë që projekti duhet të krijojë me strukturat e mbështetura prej tij, që të mund të vijojë puna edhe pas përfundimit të tij. Pasi jo rrallë herë ka pasur projekte ambicioze për krijimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit mjedisor, por që nuk kanë arritur të sigurojnë vazhdimësinë e një sistemi funksional të menaxhimit të informacionit dhe monitorimit të mjedisit.

Gjithashtu, ata shprehën mendimin e tyre për saktësimin e detyrave që do kishte për çdo njësi apo institucion që ata përfaqësonin në këtë takim.

Mbështetje këtij projekti i dhanë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, që ishin përfaqësuesit nga REC dhe INCA.



RUBRIKA GALERI



SEKTORI I TRANSPARENÇËS DHE KOMUNIKIMIT

Email: info@moe.gov.al

AKTIVITETE TË TJERA NGA MINISTRIA E MJEDISIT

DËGJESAT E PUBLIKUT PËR MUAJIN SHKURT

Ditën e hënë, datë 08.02.2016, në ambientet e Ministrisë së Mjedisit u zhvillua dëgjesa e publikut për projektligjin "Për Moratoriumin e Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë".

Pjesëmarrësit në këtë dëgjese publike përfshinin kryesisht përfaqësues nga Federata dhe Shoqatat e ndryshme të guetarëve në vend, përfaqësues të disa shoqatave mjedisore të anagazuara në mbrojtjen e biodiversitetit, staf akademik, ekspertë të pavarur mjedisore.

Takimi u hap nga znj. Elvana Ramaj, përgjegjëse e sektorit të florës dhe faunës në Drejtorinë e Biodiversitetit, e cila prezantoi nismën e re të Ministrisë për zgjatjen e Moratoriumit të Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë edhe për 5 vite të tjera.

Z. Them Perri, Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Kombëtare Shqiptare për Gjueti dhe Konservim, ndërhyri për të lexuar një Deklaratë të kësaj Federate për të shprehur mendimin e tyre kundër kësaj nisme, duke renditur si arsye kundërshtuese: dëmin ekonomik që i shkaktohej shtetit me anë të kësaj nisme, pasojat negative për guetarët, papunësinë e shtuar, etj.; të cilat sipas kësaj Federate e bënin krejt të papranueshme këtë moratorium të ri të propozuar; dhe Federata, duke qenë kategorikisht kundër, nuk do të pranonte të vijonte më tej diskutimin me përfaqësuesit e Ministrisë dhe do t'i drejtohej Kuvendit dhe institucioneve të drejtësisë për të kundërshtuar kalimin e këtij projekt-ligji.

Pas leximit të deklaratës, z. Perri dhe një numër anëtarësh të kësaj federate lanë sallën. Dëgjesa u vijua, me prezantimin që përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit bënë në lidhje me nismën e ministrit për të vijuar Moratoriumin e Gjuetisë në të gjithë territorin e Shqipërisë edhe për 5 vjet të tjera. Znj. Elvana Ramaj parashtrroi fakte dhe statistika që evidentojnë efektet

pozitive që ka patur shpallja e Moratoriumit të Gjuetisë 2 vjet më parë dhe arsyet se përse megjithë përmirësimet e vërejtura, vijimi i kësaj mase është zgjidhja që ministria propozon edhe në kushtet aktuale.

Të dhënat që u paraqitën janë produkt i monitorimeve në terren, të mbledhura nga ekspertët e projektit IPA Natura 2000, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Sipas këtyre të dhënave dhe mendimeve të shumë ekspertëve të kësaj fushe në vend, Ministria e Mjedisit ka arritur në mendimin se pavarësisht efekteve të dukshme pozitive dhe rritjes së numrit të shpendëve, krahasuar me mesataren shumëvjeçare, janë të shumta llojet e shpendëve që kanë nevojë për më shumë kohë për ripërtëritjen e nevojshme.

Gjithashtu Ministria bëri me dije edhe punën e zhvilluar nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve për zbatimin e Moratoriumit, ku përmendim ushtrimin e mbi 650 inspektimeve për gjuetinë e paligjshme, vendosjen e 40 gjobave dhe sekuestrimin e 600 armëve të gjahut.

Përgjithësisht diskutimi ishte i ndarë në dy grupe.

Grupimi i guetarëve u shpreh kategorikisht kundër një Moratoriumi të ri 5-vjeçar, të cilët paraqitën argumentat e tyre se përse kjo masë ekstreme i ndëshkonte ata dhe krijonte kosto për ta, për shtetin, përkëqësim të kushteve të tyre social-ekonomike, etj.

Grupimi tjetër, ai i përfaqësuesve të shoqatave mjedisore, u shpreh në mbështetje të Moratoriumit, por kërkoi që kjo nismë të shoqërohej nga Ministria e Mjedisit me një Plan Konkret Masash, që të garantonte zbatimin rigoroz në terren.

COP20 DO TË MBAHET NË TIRANË NË VITIN 2017

Konferenca e 19-të e Palëve Kontraktuese të Konventës së Barcelonës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe të Rajonit Bregdetar të Mesdheut ka miratuar propozimin e Ministrisë së Mjedisit, Republika e Shqipërisë për të organizuar vitin e ardhshëm në Tiranë takimin e Konferencës së Palëve COP20.

Gjatë konferencës së mbajtur në Athinë, në datat 9-12 shkurt 2016, palët e pranishme shprehën miratimin për ftesën e Shqipërisë, duke vendosur që Konferenca e 20-të e Palëve të mbahet në Tiranë në fund të vitit të ardhshëm. Shqipëria aderon në Konventën e Barcelonës prej vitit 2000. Konventa e Barcelonës dhe Protokollet e saj, sëbashku me Planin e Veprimit për Mesdheun, janë pjesë e Programit të UNEP për Detrat Rajonale.

Aktualisht, Konventa e Barcelonës ka 21 vende anëtare dhe vendet e Bashkimit Evropian. Ndër objektivat e Konventës së Barcelonës janë: vlerësimi dhe kontrolli i ndotjes detare; sigurimi i një menaxhimi të qëndrueshëm të natyrës detare dhe burimeve bregdetare; integrimi i mjedisit në zhvillimin social dhe ekonomik; mbrojtja e mjedisit detar dhe zonës bregdetare nëpërmjet parandalimit dhe reduktimit të ndotjes, dhe aq sa është e mundur eliminimi i ndotjes, qoftë kjo me bazë në tokë apo në det; mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore; forcimi i solidaritetit mes Shteteve Bregdetare të Mesdheut dhe përmirësimi i cilësisë së jetës.